

## GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

**Pml.Kzz 72/2015**

**(P. nr. 14/2013 Gjykata Themelore e Mitrovicës)**

**(PAKR 55/14 Gjykata e Apelit)**

Data:

13 tetor 2015

### NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons, (kryetar i kolegjit dhe gjyqtar referues), dhe Gjyqtari i EULEX-it Rolandus Bruin dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Moyes si procesmbajtëse, në lëndën penale P. nr. 14/2013 para Gjykatës Themelore të Mitrovicës, kundër:

**RG**, në paraburgim prej 15 nëntorit 2012,

*e të tjerëve*

*të akuzuar (me 2 të bashkakuzuar) me aktakuzën nr. PP. 81/2012 të ngritur më 12 dhjetor 2012, të ndryshuar më 17 janar 2013*

*të dënuar si në vijim;*

Pika 1 e aktakuzës për veprën penale të **Krimeve të luftës kundër popullsisë civile** në bashkëkryerje (me 2 të bashkakuzuar) për vdekjen e **GB**, sipas neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, aktualisht të dënueshme sipas neneve 31 dhe 152 (2.1) të KPK-së, dhe në shkelje të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 të Protokollit të dytë shtesë të Konventave të Gjenevës të datës 8 qershor 1977. I dënuar me 12 vjet burgim, dënim i cili pas ankesës është ndryshuar në 8 vjet burgim.

*Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur në Gjykatën Themelore të Mitrovicës nga avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit **RG** më 30 janar 2015 kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 14/2013 të datës 12 shtator 2013 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 55/14 të datës 29 tetor 2014;*

*Pas shqyrtimit të përgjigjes së Prokurorit të Shtetit ndaj kërkesës, me numër KMLP. II - ZZZK.II Nr. 54/2015 të paraqitur më 23 mars 2015;*

*Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 13 tetor 2015;*

*Në përputhje me nenin 418 dhe nenet 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPK)*

*lëshon këtë:*

---

## AKTGJYKIM

---

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit RG më 30 janar 2015 kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 14/2013 të datës 12 shtator 2013 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 55/14 të datës 29 tetor 2014 refuzohet si e pabazuar.**

### **ARSYETIMI**

#### **1. Historia e Procedurës**

1.1 Prokurori i EULEX-it i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka nisur hetimin penal në këtë çështje kundër **RG** dhe 2 të bashkakuzuarve më 14 gusht 2012 për një pikë të **Krimeve të luftës** kundër popullsisë civile. Hetimi është zgjeruar me aktvendimin e datës 10 dhjetor 2012 duke përfshirë pikën e dytë. Më 12 dhjetor 2012 prokurori special ngriti aktakuzën PP.no 81/2012 të datës 11 dhjetor 2012, dhe aktakuza e ndryshuar është ngritur më 17 janar 2013.

1.2 Shqyrtimi gjyqësor u mbajt në mes qershorit dhe gushtit 2013 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, dhe aktgjykimi u shpall më 12 shtator 2013. Aktgjykimi me shkrim iu dorëzua palëve në fillim të dhjetorit 2013. Të tre të bashkakuzuarit kanë paraqitur ankesë kundër këtij dënimi.

1.3 Në seancën e parë të Kolegjit të Apelit më 30 shtator 2014 mbrojtja paraqiti kërkesë për përjashtimin e Kolegjit të Apelit. Seanca u shty dhe kërkesa u dërgua te Kryetari i Gjykatës së Apelit, i cili më 9 tetor 2014 e refuzoi kërkesën si të pabazuar. Më 28 tetor 2014 u mbajt seanca e dytë, dhe më 29 tetor 2014 Kolegji i Apelit mbajti këshillimin dhe votimin. Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës: të pandehurit (dhe të pandehurve të tjerë) iu zbrit dënimi në 8 vjet burgim. Pjesët e tjera të ankesës së të pandehurit u refuzuan si të pabazuara dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës u konfirmua. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit iu dorëzua të pandehurve më 5 dhjetor 2014.

1.4. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur në Gjykatën Themelore të

Mitrovicës kundër të dy aktgjykimeve nga avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit **RG** më 30 janar 2015. Kërkesa është dërguar në Gjykatë Supreme më 16 mars 2015. Prokurori i Shtetit paraqiti përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë më 23 mars 2015.

## 2. Parashtrirat e palëve

2.1. Avokati mbrojtës propozon që Kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë të pranohet si e bazuar, dhe që i pandehuri të lirohet nga aktakuza në mungesë të provave pasi vepra penale nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, ose që aktgjykimet të prishen dhe lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore. Ai pretendon se të dy aktgjykimet përmbajnë shkelje esenciale të procedurës penale nga neni 384 (1) 1.12, dhe se gjykimi nuk ishte i drejtë dhe i paanshëm në kundërshtim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të KPP-së dhe nenit 6 të KEDNj-së. Ai parashtron si në vijim:

- Dënimi i bazuar vetëm në dëshminë e një dëshmitari – **JB** – dhe kjo është në kundërshtim me nenin 262 të KPP-së. Avokati mbrojtës pohon se ai interpreton këtë dispozitë në kuptimin se i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor në bazë të dëshmisë së një dëshmitari të vetëm, pavarësisht se a është ai dëshmitar bashkëpunues apo dëshmitar anonim.
- Provat e këtij dëshmitari ishte vlerësuar gabimisht për shkak të kundërthënive brenda deklaratave të tij, dhe për shkak të kundërthënive në mes të dëshmisë së tij dhe dëshmisë së dëshmitarëve të tjerë.
- Gjykata e Apelit ka shkelur nenin 384 të KPP-së duke mos bërë një shqyrtim të duhur të aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
- Gjykata e Apelit ka bërë gabim me rastin e refuzimit për të mbajtur dëgjimin në përputhje me nenin 392 (2) dhe 393 të KPP-së ashtu që **SG** të mund të jepte dëshminë e tij.
- Gjykata e Apelit nuk ka ofruar sqarim pse ishte refuzuar propozimi i avokatit mbrojtës për dëgjimin e më shumë se tre dëshmitarëve për të verifikuar alibinë e të pandehurit.

2.2. Prokurorja e Shtetit i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesën pasi që nuk ekziston asnjë shkelje e ligjit. Ajo parashtron si në vijim:

- Avokati mbrojtës i referohet vetëm shkeljes së dispozitave të procedurës penale (nenit 384 (1) 1.12) në hyrje të kërkesës së tij. Përndryshe, pretendimet e tij nuk janë asgjë më tepër sesa kundërshtime të vlerësimit të provave të cilat ai pohon se kanë çuar në vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.
- Neni 432 (2) i KPP-së përcakton se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi këtë bazë, prandaj kërkesa duhet të refuzohet.
- Nuk është paraqitur asnjë argument në mbështetje të shkeljeve të pretenduar të KPP-së, dhe të dy aktgjykimet janë përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP-së.

- Të gjitha argumentet në kërkesë i janë dorëzuar edhe trupit gjykues edhe Gjykues së Apelit, dhe janë refuzuar.
- Neni 262 i KPP-së nuk vlen për provat e **JB** dhe interpretimi i këtij neni nga avokati mbrojtës është i pasaktë.
- Nuk ka pasur shkelje të nenit 394 nga Gjykata e Apelit.
- Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka adresuar çështjen e vlerësimit të provave të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor duke i shqyrtuar ato në pajtim me parimet e përcaktuara në paragrafët e titulluar ‘Standardi i shqyrtimit.
- Lidhur me nenin 392 (2) të KPP-së, as avokati mbrojtës i **SG** as i **RG** nuk ia kanë përmendur gjykatës seancën për marrjen e provave të **SG**. Është pajtuar se kolegji i apelit nuk ka hapur shqyrtimin sipas detyrës zyrtare, mirëpo kjo është në diskrecionin e Gjykatës së Apelit. Përndryshe, deklarata e **SG** është marrë parasysh në aktgjykim.
- Gjykata e Apelit gjithashtu ka adresuar kërkesën për alibinë e propozuar të dëshmitarëve në aktgjykim.

### 3. Gjetjet e kolegjit

3.1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokati mbrojtës dhe përgjigja e Prokurores së Shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura brenda afatit kohor.

3.2. Gjykata Supreme gjen se shumica e përmbajtjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ka të bëjë me vlerësimin e provave nga Gjykata Themelore gjatë shqyrtimit gjyqësor, veçanërisht ato të dëshmitarit **JB**. Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet mbi bazën e shkeljes së ligjit penal, shkeljeve të caktuara substanciale të dispozitave të procedurës penale, apo nëse ekziston ndonjë shkelje tjetër e procedurës penale e cila ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Kërkesë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 432 i KPP-së). Është e qartë se avokati mbrojtës nuk pajtohet se si është bërë vlerësimi i provave nga trupi gjykues, e as me vërtetimin i cili është arritur si rezultat i tij. Sidoqoftë, KPP-ja është e qartë se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të përdoret si mekanizëm për t’i bërë thirrje Gjykatës Supreme që të shqyrtoj dhe vlerësojë, nga distanca, besueshmërinë e provave të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pavarësisht nëse ka pasur vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, një shqyrtim i tillë do të ishte vlerësim i gabuar.

3.3. Avokati mbrojtës pohon se kuptimi i nenit 262 paragrafëve 1 dhe 2 të KPP-së është se shpallja fajtor nuk mund të bazohet vetëm në dëshmitë e një dëshmitari të vetëm. Gjykata Supreme nuk pajtohet. Avokati mbrojtës thekson pjesën e parë të fjalisë së këtyre paragrafëve. Mirëpo, nga formulimi në tërësi është e qartë se ata i referohen situatave specifike. Paragrafi 1 i referohet situatës kur prova e tillë nuk mund të kundërshtohet me marrje në pyetje gjatë procedurës penale dhe, në paragrafin 2 kur shpallja fajtor bazohet vetëm në deklaratat e dhëna nga i pandehuri në Polici apo para Prokurorit të Shtetit. Avokati mbrojtës ka pasur mundësi që gjatë shqyrtimit gjyqësor t’i kundërshtoj provat e **JB** sipas paragrafit 1, dhe është e qartë se i pandehuri nuk është shpallur fajtor vetëm në bazë të deklaratave të dhëna në Polici apo para Prokurorit të Shtetit. Prandaj, asnjëra nga këto dispozita nuk është e aplikueshme në këtë rast. **JB** nuk është as dëshmitar anonim e as

dëshmitar i mbrojtur, dhe prandaj nenit 262 paragrafët 3 dhe 4 nuk janë të aplikueshëm. Kolegji përfundon se jashtë këtyre 4 rrethanave, nuk ka asnjë kusht në ligjin e Kosovës se prova duhet patjetër të vërtetohet nga një dëshmitar tjetër, apo nga një provë tjetër, për ta shpallur fajësinë. Ndryshe nga propozimi i avokatit mbrojtës, parimi *unus testus nullus testes* nuk është përgjithësisht i aplikueshëm në procedurat penale në Kosovë. Si rezultat, kolegji nuk ka gjetur shkelje të nenit 262 apo të KPP-së në këtë pikë.

3.4. Avokati mbrojtës ka ngritur disa çështje lidhur me seancat e Gjykatës së Apelit dhe aktgjykimin. Ai pohon se për shkak të deklaratës së dhënë nga **SG** (i bashkakuzuar) në seancën e Gjykatës së Apelit më 28 tetor 2014, Gjykata e Apelit ka qenë e obliguar që të mbajë seancë për të marrë prova nga ai, ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën ta kthejë në rigjykim. Gjykata Supreme nuk pajtohet. Diskrecioni i Gjykatës së Apelit në gjetjen e bazës për të mbajtur shqyrtim në mënyrë të qartë është paraparë me nenin 392 paragrafin 1, ‘...vetëm kur është e nevojshme për të marrë prova të reja ...’, dhe vendimi për ta kthyer lëndën në Gjykatën Themelore si njëri nga opsionet të cilin Gjykata e Apelit mund ta zgjedhë është paraparë me nenin 398 paragrafin 1 (1.3) të KPP-së. Avokati mbrojtës nuk e ka vërtetuar se Gjykata e Apelit ka zbatuar këtë diskrecion në shkelje të ligjit. Avokati mbrojtës gjithashtu pohon se Gjykata e Apelit nuk ka dhënë sqarime për refuzimin e kërkesës së tij që kolegji t’i dëgjoj provat nga 3 dëshmitarë tjerë plotësues të cilët, siç pretendon ai, do të mund të paraqisnin alibinë për të pandehurin. Avokati mbrojtës udhëzohet që të shikoj paragrafin 3.6 të aktgjyimit të Gjykatës së Apelit i cili jep arsye të plota dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës. Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje të bërë nga Gjykata e Apelit gjatë zhvillimit të seancës, e as ndonjë defekt në aktgjykimin e lëshuar. Janë adresuat të gjitha çështjet e ngritura në ankesë dhe janë dhënë arsye të qarta për vendimet e tyre.

3.5. Prandaj, Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje të dispozitave të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, apo konventave ndërkombëtare dhe refuzon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

#### **Kryetar i kolegjit**

#### **Procesmbajtëse**

---

Malcolm Simmons

---

Kerry Moyes

Gjyqtar e EULEX-it

Zyrtare ligjore e EULEX-it

#### **Anëtarët e kolegjit**

---

Rolandus Bruin

---

Salih Toplica

Gjyqtar i EULEX-it

Gjyqtar i Gjykatës Supreme